

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BRADOSHNICE" sh.p.k.

Per krijimin e shoqerise "BRADOSHNICE" sh.p.k.

Sot, me dt. 03/01/2022, ne te nenshkuarit:

- **Perlat MYRTAJ**, lindur me 03/01/1970 ne Kreshpan dhe me banim ne Fier, madhor me zotesi juridike per te vepruar me Karte Identiteti Nr 033839947 dhe ID H00103054A
- **Sami POZLLOMI** lindur me 16/04/1981 ne Bajram Curri dhe me banim ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar me Karte Identiteti Nr 036167429 dhe ID I10416045I
- **Adem TREZHNJEVA** lindur me 20/11/1964 ne Bucaj dhe me banim ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar me Karte Identiteti Nr 033297367 dhe ID G41120033W

Me deshiren dhe vullnetin tone te plote ne mbeshtetje te Ligjit Nr Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare dhe Ligjit Nr 7667 date 28.01.1993" Per rregjistrimin ne regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare" vendosem qe te formulojme kete akt per themelimin e nje shoqerie tregtare private me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k.) me kushtet si me poshte:

#### NENI 1

Personat fizik te siperpermenduar, me vullnet te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar kane rënë dakort qe te krijoje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emerimin "BRADOSHNICE" (sh.p.k.) dhe me kapital themeltar 100.000 leke.

Kjo shoqeri e ka qendren ne: **Rruga Labinoti- Pallati 2- shkalla 6-Kati pare -Ap 41 -Tirane**, dhe do te njihet me emrin "BRADOSHNICE" sh.p.k. Ortaket e kesaj shoqerie jane:

**Perlat MYRTAJ**

**Sami POZLLOMI**

**Adem TREZHNJEVA**

Administrator eshte z.Perlat MYRTAJ

Shoqeria "BRADOSHNICE" sh.p.k ka te drejte te krijoj filiale te saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovim te organeve kompetente.

#### NENI 2

Shoqeria "BRADOSHNICE" sh.p.k gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

#### NENI 3

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 25 vjet.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, nese ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe perpara afatit te parashikuar ne paragrafin e pare kur per kete marrin vendim te gjithë ortaket qe bejne pjese ne shoqeri.

#### **NENI 4**

Shoqeria "BRADOSHNIĆE" sh.p.k. ka per objekt te veprimtarise se saj:

**"Ushtrim aktiviteti ne fushen energjitike (prodhim,tregetim,furnizim etj) per projektin HEC ne fshatin Bradoshnice, Bashkia Tropoje, Qarku Kukes, tregetimin e energjise elektrike qe do te prodhohet nga ky HEC, si dhe cdo veprimtari tjeter ne funksion te realizimit te projektit. Per arritjen e qellimit te mesiperm, shoqeria mund te kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e lujtshme dhe te palujtshme dhe cdo aktivitet tjeter tregetar, financiar dhe ligjor, qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e mesiperm dhe qe mund te konsiderohet e nevojshme ne menyre qe te realizohet ushtrimi i aktivitetit te shoqerise."**

#### **NENI 5**

Kapitali themeltar i shoqerise tregetare "BRADOSHNIĆE" sh.p.k eshte 100.000 i investuar nga 'tre ortaket e saj si me poshte

**Perlat MYRTAJ 60%**

**Sami POZLLOMI 20%**

**Adem TREZHNJEVA 20%**

te cilet se bashku kane investuar ne masen 100 %.

#### **NENI 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie I perket 100 % ortakeve te shoqerise,sipas kontributit te secilit, pasi te kene shlyer me pare detyrimet tatimore, fiskale dhe ato ndaj te treteve.

#### **NENI 7**

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

Ortaku nuk mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise,ata nuk pergjigjen me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

#### **NENI 8**

Ortaket mund te vendosin te pranojne ne shoqeri ortake te tjere. Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortake nje person tjeter pa pelqimin unanimit te ortakeve. Nuk mund te hiqet dore nga kjo kontrate ne menyre te njeanshme pa pelqimin e ortakeve te tjere.

Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij ne kete shoqeri eshte i detyruar qe oferten e tij per shitje tja beje ortakeve te tjere dhe nese keta te fundit nuk pranojne te blejne ose nuk japin pergjigje brenda tridhjete diteve nga dita e berjes se ofertes ,vetem atehere ortaku eshte i lire te disponoje pjesen e tij.

#### NENI 9

Ortakët janë të detyruar të ruajnë karakterin konfidencial të aktivitetit të shoqërisë. Ortaku që shkel detyrimin e mesipër dhe nga kjo shkelje shoqërisë i shkaktohet një dëm është i detyruar të shpërblejë dëmin.

#### NENI 10

Marredheniet e punës në shoqëri ose në filiale të saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### NENI 11

Konfliktet që lindin nëndërmjet ortakëve duhet të zgjidhen në marrëveshje midis tyre. Në qoftë se ortakët nuk merren vesh për zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim kompetent për zgjidhjen e këtyre konflikteve është Gjykata e Rrethit ku e ka selinë shoqëria.

#### NENI 12

Ortakët kanë të drejtë kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga asambleja e ortakëve ;

- ◆ Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregetare të shoqërisë në përputhje me kontratën dhe statutin.
- ◆ Të kërkojnë dhe tu japin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara, nga shoqëria (bilanci, libra llogarie)
- ◆ Të bëjnë propozime dhe ti paraqesë ato ato me shkrim para administratorit dhe asamblese së shoqërisë
- ◆ Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.

#### NENI 13

Dispozita me të hollësisht për organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e Saj. Ortakët pasi lexuan me vëmendje kontratën e mesipër dhe e gjeten komform vullnetit të tyre dhe me po këtë vullnet e firmosën këtë kontratë.

#### NENI 14

Mosmarrëveshjet juridiko-civile të lindura midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, kur nuk mund të zgjidhen me mirekuptim me njëri tjetrin, do të zgjidhen nga Gjykata e rrethit ose çdo gjykatë tjetër kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

#### NENI 15

Ky akt-themelimi përpilohet në tre kopje të barabarta në gjuhën shqipe dhe hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Një kopje e këtij akt-themelimi do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregetare.

### THEMELUESIT

Perlat MYRTAJ

Sami POZLLOMI

Adem TREZHNEVA